

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E  
ANKIMIMIT**

*[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]*

**Datë:** 12.06.2026

**Drejtuar:** Operatorit Ekonomik **4 S sh.p.k** – me NIPT : L64425401K dhe me adresë: Fier, Lushnje, Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)**

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO  JO**

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO  JO**

Nëse po, të jepen dhënat: \_\_\_\_\_

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

\* \* \*

Tipi i Kontratës: Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur - Mallra

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF - 85563-05 -14 -2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje produkte ushqimore për nevojat e kopshteve, çerdheve dhe konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale”.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 15.05.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Datë 18.05.2026,  
Buletini nr 32

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. **“4 S” sh.p.k** **NIPT: L64425401K**

Vlera: 13,625,000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_  
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. **OE - “G E A” sh.p.k** **NIPT: K33931040W**

Vlera: 15,460,246 (pesëmbëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH .

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_  
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

1.OE - **“G E A” sh.p.k** **NIPT: K33931040W**

Arsyet:

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit nr 2.3.ç të cituar në shtojcën nr 8 të dokumentave standarde të tenderit për të provuar kapacitetin teknik të operatorit për realizimin e kontratës pasi nuk rezulton të kete deklarim / dokumentacion qe provon se ka në pronesi ose me qera/perdorim ambient për ruajtjen e ushqimit (magazine ushqimore) në territorin e bashkise Lushnje shoqeruar me

dokumentacionin e kerkuar ne DST. Dokumentacioni i vene ne dispozicion i perket nje magazine ushqimore në Maliq, Korçë.

- Nuk përmbushet kriteri i vendosur ne pikën 2.3.d per te provuar kapacitetin teknik i vendosur në shtojcën nr 8 të dokumentave standarde të tenderit te operatorit ekonomik. Kontrata e vënë në dispozicion per te vertetuar se operatori ekonomik ka marrë me qera një furrë buke, nuk shtrihet per gjithë periudhen e zbatimit të marreveshjes kuader ne fjale pasi afati i saj mbaron me 21.01.2027 ndersa marreveshja kuader qe Qendra e Arsimit Lushnje synon të lidhe i shtrin efektet 12 muaj nga data e nënshkrimit të saj (pra minimalisht deri ne Qershor të vitit 2027).
- Nuk përmbushet kriteri i veçantë vendosur ne pikën 2.3.dh per te provuar kapacitetin teknik i vendosur në shtojcën nr 8 të dokumentave standarde të tenderit. Kontrata e bashkengjitur ne sistem per te vertetuar se operatori ekonomik ka kontrate furnizimi me nje pike tregtimi te mishit dhe nenprodukte te tij nuk shtrihet per gjithë periudhen e zbatimit të marreveshjes kuader ne fjale pasi afati i saj mbaron me 04.02.2027 ndersa marreveshja kuader qe Qendra e Arsimit Lushnje synon të lidhe i shtrin efektet 12 muaj nga data e nënshkrimit të saj (pra minimalisht deri ne Qershor të vitit 2027). Kontratat e furnizimit te lidhura me fermerë të ndryshem jane te vlefshme por keta fermere nuk disponojne license leshuar nga QKL me kodin II.1.A.1 ose II.1.B per te vertetuar se keto subjekte jane te licensuara per te ushtruar kete aktivitet.
- Nuk përmbushet kriteri i veçantë vendosur ne pikën 2.3.e per te provuar kapacitetin teknik i vendosur në shtojcën nr 8 të dokumentave standarde të tenderit. Kontrata e vënë në dispozicion per te vertetuar se operatori ekonomik ka marrëveshje bashkepunimi me nje njesi prodhim bulmeti, ka përfunduar me date 24.06.2026.
- Nuk përmbushet kriteri i veçantë vendosur ne pikën 2.3.f per te provuar kapacitetin teknik i vendosur në shtojcën nr 8 të dokumentave standarde të tenderit. Mungon dokumentacioni qe provon se operatori ekonomik ka në pronesi, perdorim ose kontrate furnizimi me kompleks stallor. Kontratat e furnizimit te lidhura me fermerë të ndryshem jane te vlefshme por keta fermere nuk disponojne license leshuar nga QKL me kodin II.1.A.1 ose II.1.B per te vertetuar se keto subjekte jane te licensuara per te ushtruar kete aktivitet.
- Nuk përmbushet kriteri i veçantë vendosur ne pikën 2.3.g per te provuar kapacitetin teknik i vendosur në shtojcën nr 8 të dokumentave standarde të tenderit. Mungon dokumentacioni qe provon se operatori ekonomik ka në pronesi, perdorim ose kontrate furnizimi me kompleks pularie. Kontratat e furnizimit te lidhura me fermerë të ndryshem jane te vlefshme por keta fermere nuk disponojne license leshuar nga QKL me kodin II.1.A.1 ose II.1.B per te vertetuar se keto subjekte jane te licensuara per te ushtruar kete aktivitet.

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. “4 S” sh.p.k

**NIPT: L64425401K**

Vlera: 13,625,000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.